




Pranuar / Dorezuar Priljezi/Prodato Received/Delivery	09.12.2022	2	viti god year
Organ /Njesia Org./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKMYSHK	7863/2022		115



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1022/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani anëtarë, si dhe Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1022/2022 të datës 17.11.2022 të parashtruar nga ankuesja me adresë banimi kundër Vendimit me 02 Nr.257/2022 të datës 26.10.2022 të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Istogut, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 09.12.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pa bazuar Ankesa me numër A.nr.1022/2022 e datës 17.11.2022 e parashtruar nga ankuesja

II. Mbetet ne fuqi Vendimi 02 Nr.257/2022 i datës 26.10.2022 i Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Istogut.

A r s y e t i m

Ankuesja ka aplikuar në konkursin e shpallur për pozitën e punës "Specialist i Administrimit të Përgjithshëm" me numër reference RN00009987 të shpallur me datën 11.10.2022-18.10.2022 sipas njoftimit të datës 20.09.2022.

Sektori i Burimeve Njerëzore në kuadër të Komunës së Istogut me datë 21.09.2021 për pozitën "Specialist i Administrimit të Përgjithshëm" me numër reference RN00009987 pas verifikimit paraparak nga SIMBNJ ka njoftuar kandidatët që nuk i kanë plotësuar kriteret e konkursit, në mesin e tyre edhe kandidatja/ankuesja

Ankuesja ka parashtruar ankesë pas verifikimit paraparak nga SIMBNJ ku ka njoftuar kandidatët që nuk i kanë plotësuar kriteret e konkursit. Me vendimin me 02 nr. 257/2022 të datës 26.10.2022 të Njesisë së Burimeve Njerëzore Komuna e Istogut ka refuzuar ankesën e ankueses për mosplotësimin e kushteve të përgjithshme formale të konkursit të shpallur për pozitën "Specialist i Administrimit të Përgjithshëm".

Kundër vendimit me 02 Nr.257/2022 të datës 26.10.2022 të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunes së Istogut me datë 17.11.2022 ankuesja ka parashtruar ankesë me numër protokollit 7195/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, më datë 25.11.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Istogut, ndërsa kjo e fundit me datë 06.12.2022 ka përcjell përgjigjen në ankesë me numër protokollit 7691/2022 së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave me rastin e vendimmarrjes, ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 7227/2022 të datës 18.11.2022 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me email; Vendimi i datës 21.10.2022 me protokoll 02 Nr.239/2022 nga zyra e personelit; Vendimi i datës 26.10.2022 me protokoll 02 Nr.257/2022 nga zyra e personelit; Emaili i datës 17.11.2022 nga ankuesja; Ankesën me numër të protokollit 7195/2022 të datës 17.11.2022 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Letërnjoftimi i ankueses; Ankesë për Zyrën e Personelit të Komunës së Istogut i datës 23.10.2022; Shtojca Nr.1/10 për përshkrimin e punës për klasën profesional 3; Konkurs me RN00008586 i datës 10.03.2022 për pozite Zyrtar për Gjendje Civile 4; Konkurs me RN000086505 i datës 09.03.2022 për pozite Zyrtar për Gjendje Civile 1; Konkurs me RN00007112 i datës 14.06.2021 për pozite Zyrtar për Gjendje Civile 4; Konkurs me RN00007194 i datës 28.06.2021 për pozite Zyrtar për Gjendje Civile 1; Konkurs me RN00007031 i datës 03.06.2021 për pozite Zyrtar për Gjendje Civile 1; Konkurs me RN00007072 i datës 09.06.2021 për pozite Zyrtar për Gjendje Civile 1; Konkurs me RN00007306 i datës 02.08.2021 për pozite Zyrtar për Gjendje Civile 4; Konkurs me RN00007988 i datës 17.12.2021 për pozitën Specialist i Administrimit të Përgjithshëm; Konkurs me RN00009518 i datës 22.07.2022 për pozitën Specialist i Administrimit të Përgjithshëm; Konkurs me RN00009824 i datës 24.08.2021 për pozitën Specialist i Administrimit të Përgjithshëm; Konkurs me RN00009885 i datës 06.09.2022 për pozitën Specialist i Administrimit të Përgjithshëm; Konkurs me RN00010357 i datës 07.11.2022 për pozitën Specialist i Administrimit të Përgjithshëm; Konkurs me RN00010380 i datës 08.11.2022 për pozitën Specialist i Administrimit të Përgjithshëm; Konkurs me RN00009184 i datës 08.06.2022 për pozitën Specialist i Administrimit të Përgjithshëm; Konkurs me RN00009332 i datës 29.06.2022 për pozitën Specialist i Administrimit të Përgjithshëm; Konkurs me RN00009155 i datës 03.06.2022 për pozitën Specialist i Administrimit të Përgjithshëm; Konkurs me RN00007545 i datës 26.08.2022 për pozitën Specialist i Administrimit të Përgjithshëm; Konkurs me RN00009519 i datës 22.07.2022 për pozitën Specialist i

Administrimit të Përgjithshëm; Konkurs me RN00008496 i datës 28.02.2022 për pozitën Specialist i Administrimit të Përgjithshëm; Konkurs me RN00008619 i datës 16.03.2022 për pozite Specialist i Administrimit të Përgjithshëm; Konkurs me RN00006598 i datës 26.03.2022 për pozitën Zyrtar për Barazi Gjinore; Përgjigje në kërkesë nga organi i punësimit e datës 06.12.2022 me numër protokollit 7691/2022 bashkë me shkresat e lëndës; Konkursin për pozitën e punës "Specialist i Administrimit të Përgjithshëm" me numër reference RN00009987 të shpallur me datën 11.10.2022-18.10.2022 sipas njoftimit të datës 20.09.2022; Konkurs me RN00007233 i datës 02.07.2021 për pozitën Zyrtar për Gjendje Civile 1; Konkurs me RN00007194 i datës 28.06.2021 për pozitën Zyrtar për Gjendje Civile 1; Konkurs me RN00007306 i datës 02.08.2021 për pozitën Zyrtar për Gjendje Civile 4; Konkurs me RN00006279 i datës 27.01.2021 për pozitën Zyrtar për Gjendje Civile 1; Konkurs me RN00008586 i datës 10.03.2022 për pozitën Zyrtar për Gjendje Civile 4; Konkurs me RN00007072 i datës 09.06.2021 për pozitën Zyrtar për Gjendje Civile 1; Konkurs me RN00007031 i datës 03.06.2021 për pozitën Zyrtar për Gjendje Civile 1; Rezultatet Preliminare nga Zyra e Personelit e Komunës së Istogut i datës 21.10.2022; Rezultatet Preliminare nga Zyra e Personelit e Komunës së Istogut i datës 26.10.2022; Lista e aplikantëve RN00009987 dhe Diplomë e datës 11.06.2018 Nr.66/18 e lëshuar nga kolegji Dardania në Prishtinë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe analizimit të provave të lëndës, konstatoi se ankesa e ankueses **është e pabazuar, SEPSE:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës është konstatuar së më datë 20.09.2022 në Sistemin Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (SIMBNJ) është shpallur njoftimi lidhur me hapjen e konkursit për pozitën e punës "Specialist i Administrimit të Përgjithshëm" me numër reference RN00009987, dhe si kritere të përgjithshme formale për pozitën "Specialist i Administrimit të Përgjithshëm" kanë qenë të përcaktuara:

Arsimimi i kërkuar: Diploma e studimeve universitare me të paktën 180 kredi/ECTS apo ekuivalente me to; **Kualifikimi:** Fakulteti Juridik, Administratë Publike; **Përvoja e punës:** Nuk kërkohet

Sipas shkresave të lëndës rezulton se ankuesja ka aplikuar në konkursin e shpallur për pozitën e punës "Specialist i Administrimit të Përgjithshëm" me numër reference RN00009987 të shpallur me datën 11.10.2022-18.10.2022 sipas njoftimit të datës 20.09.2022. Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Komunës së Istogut me datë 21.10.2022 kanë njoftuar kandidatët që nuk i kanë plotësuar kriteret e konkursit.

Kundër vendimit të datës 21.10.2022 ankuesja me datën 23.10.2022 ka parashtruar ankesë në Njësinë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Istogut e cila pretendon se i ka plotësuar kriteret e konkursit për pozitën "Specialist i Administrimit të Përgjithshëm".

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se i është bërë e pa drejtë nga Njësia e Burimeve Njerëzore me rastin e refuzimit të aplikacionit për pozitën e punës "Specialist i Administrimit të Përgjithshëm" sepse e njëjta pretendon se i ka plotësuar kriteret e konkursit pasi që sipas ankueses Diploma Bachelor në Psikologji Aplikative dhe Studime Menaxheriale e përfunduar në Kolegjin "Dardania" është ekuivalente me Fakultetin Juridik dhe Administratë Publike .

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave lidhur me pretendimet ankimore të ankueses ka shqyrtuar shkresat e lëndës një nga një dhe rrjedhimisht ka konstatuar se ankuesja ka përfunduar studimet themelore dhe posedon Diplomën Bachelor në *Psikologji Aplikative dhe Studime Menaxheriale* e përfunduar në Kolegjin "Dardania" me gjithsej 180 kredi/ECTS.

Andaj, bazuar si me sipër Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave vlerëson se ankuesja me rastin e aplikimit për pozitën përkatëse të punës, ku afati i aplikimit ishte nga data 11.10.2022 deri me datë 18.10.2022 nuk ka plotësuar kriterin e konkursit lidhur me arsimimin, ku përcaktohet: Diploma e studimeve universitare me të paktën 180 kredi/ECTS, *kualifikimi; Fakulteti Juridik dhe Administratë Publike*. Në këtë kuptim Kolegji konstaton se pretendimet ankimore të ankueses janë të pabazuara dhe rrjedhimisht vlerëson se Njësia për Burime Njerëzore në Komunën e Istogut, me rastin e nxjerrjes së vendimit 02 Nr.257/2022 të datës 26.10.2022 për refuzimin e ankesës së ankueses për mosplotësimin e kërkesave të përgjithshme formale të konkursit si të pa bazuar, ka vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plote gjendjen faktike dhe rrjedhimisht drejtë ka zbatuar ligjin material, duke vepruar kështu në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-144 për Zyrtaret Publikë, dhe nenit 15 paragrafi 3 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ku përcaktohet se "*3.Në përfundim të verifikimit paraprak, Njësia Përgjegjëse përcakton kandidatët që plotësojnë kushtet për aplikim. Vetëm kandidatët që plotësojnë kushtet për aplikim kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurimin në fazën e mëtejshme, e cila njihet si lista e ngushtë*".

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.


Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi.

Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.1022/2022, datë 09.12.2022.

Sabile Avdyli



Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet;

- Ankueses,
- Kryetarit të Komunës së Istogut;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Istogut; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

